


ALBANA REXHA

BIBLIOTEKA

85H-1

R 63



MOS IK NGA UNE


*Poezi
dhe skica*

PSH-1

R 63

Albana Rexha

Mos ik nga unë



Shtëpia botuese "Naim Frashëri"
Tiranë 1994

ESHTË MBASE NJË LIBËR I
SHKRUAR KEQ, POR ËSHTË NJË PJESE
IMJA. DHE TI GJITHMONË MË KE
DASHUR PËR KËTË QË JAM E PËR
KAQ SA MUNDEM...

DY RRESHTA PËR TY

I KUSHTOHET OLTËS

Ky qiell shtatori drejt të cilit ti po hap krahët të fluturosh, është një pjesë e ëndrrave të tua të paplotësuara... Dhe muret përgjatë periferive janë zhgarravitur fund e krye me emra dashnorësh... Yjet shkëputen e bien në parqet e zhveshura, tek ato stolat e vjetëruar të pasditeve ku ti ulesh e rri ndonjëherë... Rrotull teje mbijnë pellgje të vogla uji dhe ti nuk ke asgjë me vete, përveç atyre puthjeve të tua të ëndërrta, të pashkëmbyera kurrë... Pastaj zogjtë ikin me zhurmë nëpër qiejt e murrëtyer e të zbardhur rishtazi... Dhe ti nis përditë një letër të gjatë dashurie... Dhe asnëherë s'e mbaron...

Deti shtyhet pas brigjeve dhe plazhet lagen nga shirat e netëve... Retë e bardhë kanë ikur... Ti dëgjon si e vrarë ca tinguj për së largu dhe qan... Dielli është përmbytur dhe errësira ka erë mollësh... Ti je në gjumë. Majat e pishave lëkundën nga era. Dhe mbi ty është po ai qiell drejt të cilit ti nuk mundë dot të fluturoje...

Por..., ajo shushurimë e ëmbël jete..., ajo

shkëndijë e bardhë drite, ajo kambanë e vockël fati që
quhet shpresë..., do të të zgjojë një ditë e do të të
shkundë nga mërzia.

Ke për të parë!

Qershor, '93

MBASE KUR QIELLI TË QE PAK MË BLU...

Ajo që ndjeja që akoma e ngathët...
dhe një tango e vjetër dëgjohej diku...,
po e dija që një ditë patjetër do të ndodhte...
Mbase kur qielli të që pak më blu...

'92

KUKULLA

Ajo kish veshur këpucë të reja, të bardha, të ndritshme... Dhe teksa hidhte ato hapat e saj të vegjël mbi trotuar..., ajo gjeti një kukull... E mori shpejt e shpejt, e fshehu poshtë rrobave dhe u kthye me vrap në shtëpi. Kukulla kishte një nishan majë hundës dhe sytë i kishte bojëqielli. Ajo e lau dhe e fshehu poshtë jastëkut... Tërë natën i sajoi një fustan të vogël me shaminë e saj... Dhe pastaj e veshi, e puthi dhe e quajti Ema.

16 vjet më vonë ajo lindi një bebe të vogël me sy bojëqielli dhe me një nishan majë hundës, njësoj si kukulla e saj... Ajo qau, e puthi dhe e quajti Ema.

Gusht '93

LYPËSI

Çdo të shtunë në mëngjes ai i binte derës time dhe kërkonte një copë bukë. Unë i jepja ndonjë gjë dhe e shikoja tek ato sytë që i shkëlqenin aq shumë... Ai vinte dorën e tij të vogël te dora ime dhe qeshte... Unë s'kam parë kurrë sy që të qeshnin aq bukur, sa sytë e tij... Thoshte ndonjë gjë, pastaj pinte një gotë ujë dhe ikte me ato këmbët e tij të zbathura e të gërvishura... E kështu me rradhë për muaj të tërë... Dhe pakuptuar më hyri aq shumë në zemër, sa që kur ai nuk vinte, mërzitesha... Nuk e di. Asgjë s'më sillte aq mbarësi, sa ato sytë e tij kur qeshnin... Po ai nuk erdhi më.

Atë ditë kisha patur ditëlindjen. Qe e shtunë. Mbi tavolinë qe një rrëmujë e tërë gotash... Gota të panisura, gota bosh, gota përgjysëm... Mbi to bridhte ajri i ndenjtur dhe unë i shkoja gjithë përtesë... Isha e lodhur... Megjithatë shtyva kanatet dhe nisa të vë gjërat nëpër vende. Atë kohë ra dera. E hapa dhe s'po u besoja syve... Te këmbët e mija qe një shportë kashte me trëndafila... Qenë të sapoçelur, të kuq, si të kadifenjtë... Unë u shtanga dhe s'po lëvizja nga vendi... Atë çast

pashë kokën e tij të vogël..., që u zgjat...

- Të kapa ëë?... - i thashë duke qeshur... Ai vrapoi tek unë dhe më hodhi duart në qafë. Qeshte. Dhe unë s'kam parë kurrë sy që të qeshi aq bukur...

Gusht '93

ANDIA

Ajo e pa me ato sytë si mace dhe qeshi. Në shtëpinë përballë u ndez një dritë. Gjysma e fytyrës së saj u ndriçua, gjysma jo... Ajo nuk qeshi më... - Do iki... - tha pastaj dhe ngrit prej andej... Ai e njihte përmendësh atë zë. U zgjat dhe e tërhoqi fort pas vetes. Fryma e saj e trembur iu përplas tek sytë pastaj iu derdh me rrëmbim nëpër trup... Ajo pëshpëriti... Dhe pastaj nata që po ikte... Ajo që ishte ende aty, si e dalë nga përrallat... ai vetë që e shihte, e donte, e mundonte... Dhe prapë ajo. Krijesa që i përkiste. E vdekur kur ai të vdiste...

Andia u kthye nga muri... Ai u kap pas trupit të saj, e puthi te flokët dhe tha diçka nëpër dhëmbë. Pastaj drita përjashta u shua dhe mbi xham varej vetëm një fill hëne.

- Andia çou, mjaft fjete...

Ajo hapi sytë ngadalë si kukull...

-Kam parë në ëndërr një hënë të madhe, argjendi...

- tha si me vete.. Pastaj kryqëzoi duart dhe pa nga ai. Në gisht kishte një unazë... Shtyu jastëkët në tokë dhe

ktheu kokën nga muri... Iu duk sikur ishte ende në
ëndërr... Pastaj u kthye nga ai... e aq fort ia nguli sytë...
sa që të dy qeshën...

Ajo që ulur përtokë. Kaçurrelat i bini mbi sytë e
saj të mëdhenj, të lyer fort. Fytyrën e kishte të enjtur
dhe të zbehtë... Megjithatë që e bukur... - Shiko
përfashtat... - tha ai.

Ajo ktheu kokën me trishtim. Që tutje dukej
perëndimi... I kuq e i shprishur... Ai u afrua dhe e puti
te sytë.

- E di?... tha ajo, po të vdes ndonjëherë dua të m'i
lësh sytë hapur. Zërin e kishte të mërzhitur, sikur do ia
plaste të qarës...

- Pse?... - tha ai.

- Nuk e di. Ashtu dua... - Vazhdoi ajo. Pastaj
qeshi sikur donte ta harronte atë që tha dhe iu afrua
pasqyrës. Ndenji një çast ashtu, pastaj iu kthye me vrik
dhe iu hodh në qafë. Ai e rrotulloi në ajër gjersa iu
morën mendtë. Nga flokët e ngatrupi dilte ajo era e saj
e njohur dhe e butë, si erë fëmije...

- Ika... - tha ajo. U bëra vonë. Ai i pati edhe një
çast para tij sytë e saj të mëdhenj, pastaj ajo u zhduk.
Atje tej kishte mbetur vetëm perëndimi..., ashtu i kuq
e i shprishur...

3 vjet më pas.

- Andia...

Ajo nuk i hapi sytë.

- Kam dëgjuar në ëndërr një kabanë që binte...

Ai nuk foli.

Andia i kapi dorën dhe ia shtrëngoi pas vetes... Pastaj hapi sytë. Fytyrën e kishte të vrarë dhe sytë i ngjanin si të shuar... Kur i puthi duart, atij i shkuan sytë tek unaza dhe u drodh... Kujtimet iu sulën nga të gjitha anët dhe po e mbysnin...

Andia pati qenë dashuria e tij e parë. Ajo kishte qenë për të si një kukull që mund ta shihte vetëm pas xhamash, pa mundur kurrë ta prekte, ta ndjente e ta kishte të veten... Ajo qe bërë ëndrra e tij që pas atij shikimit të parë, të ndrojtur e të shkurtër... Dhe aq e bukur, aq e trishtuar, aq e pamundur, aq kokëfortë e aq e pashpresë i qe dukur ajo ëndërr, saqë edhe kur Andia u bë e tij, ai asnjëherë, kurrë, s'e besoi këtë...

Ndezi një cigare dhe u kthye nga ajo.

Andia qe ulur përtokë. Njësoj si atëherë. Flokët

i ishin shprishur dhe gjunjët i kishte shumë të dobët... Ato sytë që e patën mbërthyer e çmendur aq shumë dikur..., ngjanin tani si të shplarë e të mjerë... Atij i erdhi të qante.

- Nëm dhe mua një cigare... - tha ajo. Ai ia dha dhe u afrua. Ajo po e shikonte me ato sytë e saj të munduar, sikur të donte t'i lutej...

- Nuk kam harruar... - tha pastaj ai dhe e përqafoi. Dhe para tyre që po ai perëndim i atëhershëm, i vjetër, i kuq e i shprishur...

3 javë e gjysmë më pas.

Andia u zgjua duke qarë. Mbi sy ndjeu një njollë të madhe, verbuese. Qe dielli... U ngrit ndenjor mbi shtrat dhe thirri emrin e vet. Dëshpërimi i nisi nga buzët, pastaj i rrëqiti ngadalë midis brinjëve..., poshtë gjunjëve, gjer në gishta... Ashtu me sy të lagur ajo e ndjeu se ai fill drite që i fundit për të... Grisi një fletë dhe u mundua të shkruante. Duart i dridheshin dhe nuk shikonte mirë.

... "Kësaj nate t'i s' do mund të flesh, gjersa qielli të zbardhet. Unë e di. Nga errësira do dalin kohët, rrugët, ditët e netët që ikën... Dhe unë do të vij drejt

teje, do eci e vetme nëpër sallonin e errët, po nuk do takohemi dot... Do të jetë veç një vegim. Dhe mos vrapo pas tij sepse ai vegim s'do të të çojë askund... Andia”

La lapsin dhe shtyu sytë në jastëk.

Po atë pasdite.

- Kam frikë... - tha ajo. Kam shumë frikë... Ai e mbante shtrënguar pas vetes. Sytë e saj e shikonin ashtu të mëdhenj, të zinj e të pikëlluar... Gjithë jetën ai do e merrte me vete atë shikim... - Më kujto ndonjëherë... - tha ajo pastaj...

Me zemrën që po i shkallmohej nga të rrahurat ai u përkul dhe e puthi... Në atë frymë të fundit, ajo qeshi... Pastaj sytë iu tretën larg, aty ku qielli që i pafund... Ai kurrë s'e pat parë më të bukur se atë... Dhe ishte ende aty, në krahët e tij e megjithatë nuk ishte më... Nga jashtë dëgjohej zhurma e trishtuar e ujit dhe mbi jastëkun e saj që një letër. Ai e hapi... Pastaj shtrëngoi një cigare midis dhëmbëve dhe kërkoi shkrepjen. Kur flaka shkëlqeu dhe u lëkund, ndjeu që lotët iu rrokullisën me nxit mbi ato gërma të trishtuara e të fundit, që qenë lidhur me zor njëra pas tjetrës, gjersa patën shkruar “Andia”...

Dhe ai ulëriti me sa kishte në kokë. Gjersa iu
shqye zemra... Ndërsa ajo heshtej aty afër tij me sytë
akoma të hapur... E bukur si asnjëherë...

Tetor, '93

MË ZGJO

Vjeshta po humbet...
dhe ky diell i fundit më bie në sytë,
aq shumë sa nuk më lë të t'shoh
Më zgjo...,
sepse shirat po kthehen sërish...
dhe vdekja do pikojë ngadalë...
mbi kohën që unë prish pareshtur...
Pa të parë.

'92

17

53951



NJË HISTORI E SHKURTËR

Jo, unë asgjë s'mund të kem më të shtrenjtë se ty... Unë të ndjej kur ti lëviz... Dhe akoma s'e besoj që po rris një jetë tjetër bashkë me jetën time... Po ti vogëlushja ime je vërtet këtu brenda meje. Ti je këtu princesha ime e vogël. Dhe do lindësh bashkë me diellin... Unë e di. Jo, asgjë s'mund të kem më të shtrenjtë se ty... Ja shiko, kam hapur krahët të të mbaj... Po të pres. Ti nuk e di sa me et' po të pres. Jetën e kam vetëm për ty...

... Kur ajo i shkroi këto rreshta data qe 17 maj. Një muaj më vonë ajo vdiq në lindje. Fëmija shpëtoi. Thonë se ish fëmija më i bukur që pat lindur atë stinë...

Qershor '93

ZEMËR GRUAJE

Trupi i tij i shtrirë, i pajetë e i ngrirë... Ajo goja e ti e ndytë që kish heshtur përgjithmonë. Sytë e mbyllur dhe duart e kryqëzuara. Ai nuk qe më. Ajo mori frymë thellë dhe vuri prizën e kafes... Pas xhamave ngjitej një mëngjes i pistë shkurti.

Qe ndjerë përnjëherësh e plakur, që në atë orë të parë, kur ai i vuri në gisht atë rrethin e hollë, të florinjte... Dhe kjo pat ndodhur dhjetë vjet të shkuara... Ajo akoma i kujtonte ditët e saj të atëhershme, kur ai kthehej i pirë dhe ashtu i pistë e plaste në shtrat në sy të fëmijëve... Ajo kohë vazhdonte ta mbyste. Ai ia pat mbyllur jetën mes katër muresh. E kish hequr zvarrë, e kish pështyrë, ia kish shuar cigaret në trup, e kish shkelur me këmbë. Dhe tërë jetën ajo kish marrë me vete ulëritjet, poshtërimin, skamjen, rraskapitjen dhe fatin e saj të mbrapshtë... Kurrë s'kish parë një ditë të bardhë... Dhe asnjëherë s'kish mësuar të ankohej... Asnjëherë s'e kish mallkuar, asnjëherë s'qe bërë kundër tij... Tërë jetën qe zgjuar e kish fjetur me fëmijët pas

trupit, dhe i kish shkelur vitet e saj njeri pas tjetrit... E ajo mërzi e gjatë, e pashpresë, e paskaj ia pat bërë shpirtin zvagër...

Hodhi kafen në filxhan dhe pa nga ai... I erdhi ta godiste, ta shqyente, t'i ulërinte, ta pështynte, ashtu si bënte ai dikur..., por ai trup i shtrirë aty që i pajetë, i pambrojtur e i gjorë... Ashtu e hutuar, ajo befas mbuloi fytyrën me duar dhe tha një lutje nëpër dhëmbë... Pastaj u mbështet mbi trupin e tij dhe qau.

Qershor '93

ENDËRR

Nata binte mbi ne, ngadalë, si lot... Unë isha mbështetur te ty dhe s'flisja. Hëna binte pjerrtas mbi drurët dhe ndriçonte fort. Doja që ti të më puthje. Ajri qe si i kaltër, po ti nuk e kishte mendjen aty... As tek unë nuk e kishe... Rrije ashtu i heshtur me shikimin në asgjë... Unë vura kokën te ty dhe të ndjeva frymën. Qe një frymë e mërzitur dhe e gjatë... Më ndante vetëm një centimetër nga goja jote... I hoqa sytë prej andej dhe pashë qiellin... Ai ngrihej mbi ne më i madh se kurrë po ti nuk doje të flisnim për këtë. Për asgjë nuk doje të flisnim. Po ajri qe i kaltër dhe ashtu si e dehur... Unë u ktheva nga ty dhe të putha... Ti po më shikoje... Pastaj vure njërin bërryl mbi bar dhe më tërhoqe nga flokët... E ndjeva gjer te brinjët atë prekje të thjeshtë... Nga fundi i shpirti m'u ngrit me këmbëngulje një mall i panjohur për ty... Dhe qe një mall torturues... Më lidhej një gjë në grykë e s'merrja dot frymë... Hëna i mbante sytë tek unë... po për mua në botë ishte vetëm ti... Ti që më doje... Dhe e shtyrë në atë lëkundje marramendëse, ndjeja një lloj vuajtjeje që zgjatej gjer në frikë... Që më i përsërituri e më i shtrenjti mundim në botë...

Pastaj u ndjeva aq e këputur e aq në faj, sa desha

të mos isha... Me lotët që s'më pushonin të thirra, të urreva e të ndjeva brenda të njëjtës frymë... Tek unë ti kishe zgjuar më të fshehtën e më tekanjozen ëndërr që mbaja në shpirt... Dhe e pate zgjuar, ashtu si vetëm ti di të zgjosh një ëndërr... Kur më kape pastaj duart, u ndjeva befaz tmerrësisht • jotja... Dhe ashtu e strukur pas teje, pashë për herë të fundit qiellin e çuditshëm të asaj nate... Hëna nuk binte më pjerrtaz. Dhe ndriçonte me një lloj mërzie. Nuk e di...

Pastaj ti afrove sytë tek unë dhe më puthe ashtu si puthen fëmijët para se të flenë... Bashkë me frymën më doli nga shpirti dhe një e qeshur...

Të nesërmen u zgjova me diellin mbi shpinë. Ajri që i kaltër, po ti nuk ishe aty... U ngrita nga shtrati dhe ashtu zbathur siç isha zbrita gjer poshtë shkallëve... Jashtë që vetëm vjeshta. E ndritshme, e zhveshur, e lodhur...

'92

MBASE NUK QE KAQ E THJESHTË

As atë ditë, as të nesërmen, as më vonë

Ajo nuk mundi të ecte...

dhe kujtoi se asnjë e qeshur s'do i dilte më nga shpirti...

kujtoi se kurrë ndonjëherë s'do të mundej të flinte...

dhe shpinën e ktheu nga qielli e vendosi të vdiste...

Pastaj kur dielli fshehtas e puthi tek flokët

dhe sytë e trishtuar ajo ktheu drejt tij,

në zemër i arriti një rreze e vogël

dhe të rrahurat ishte vonë të ndaleshin tani...

... E mbase nuk qe kaq ę thjeshtë...

E di.

Mars '94

SIRENETA

Në ankimin që buzët nuk nxorrën,
në mundimin që sytë nuk derdhën.,
në ëndrrën që jetë nuk mori
ashtu e vetme ajo brodhi...
e zbehtë, e fildishtë, e beftë...
e lagësht, e butë, e pafaj...
për të humbur përgjithmonë pastaj.

Tetor, '93

SIKUR TË MUNDJA

I kushtohet Z.M.

Sikur të mundja që jetën time të re t'a ndaja me ty... A, sikur të mundja!... Unë e di çfarë po mendon ti tani... Dhe dua të ta heq mendjen prej andej... Dua të të marr përdore e të eci me ty..., ashtu siç bëja kur isha e vogël..., por zemrën edhe unë e kam gjithë mërzi, njësoj si ty..., sepse jeta shumë herë është e padrejtë..., ti e di...

Dhe rrugët e mia të fëminisë janë larg e nuk më shpëtojnë dot më... Të kujtohet?... Ti më tregoje ato historitë e tua të vjetra dhe unë të dëgjoja e të dëgjoja pa u lodhur kurrë..., mjaft që të isha me ty..., afër teje... A e beson, po të them, që nuk kam dashur asnjëri, aq sa të doja ty atëhere... A e beson që ti për mua fëmijën ishe gjithçka?

Ktheje kokën nga unë... Kot e fsheh atë lot... Unë e di çfarë po mendon tani... Dhe asnjëherë s'më je dukur kaq ndryshe... Dhe nuk e di pse, po kam nevojë të t'them atë që fjalët kurrë s'dinë t'a thonë... Kam nevojë të t'them, që të dua shumë, shumë, shumë... Dhe nuk e di a të ndihmon kjo... Asgjë nuk di, përveç asaj

që njeriu kundër fatit s'ngrihet dot kurrë... Dhe çfarëdo
që të ndodhë, thellë vetes ne gjithnjë bindemi që nuk
jemi as të parët as të fundit...

Orët rrokullisen... Unë vij të bëj dy hapa me
ty..., ashtu siç bëja kur isha fare e vogël... Pastaj ti ikën
ngadalë... Jeta jote e munduar të rri e tëra mbi shpinë...
Dhe unë mërzitem për ty...

Këto rrjeshta i pata shkruar në filim të shtatorit...
Tani ai nuk është më... Dhe tre javë të shkuara kur
rregulloja bibliotekën e tij të gjitha ishin po aty...,
përveç atij vetë..., për një çast unë e ndjeva aq thellë,
aq fort, aq qartë e aq afër..., pa mundur as të flisja, as
të qaja, as të lëvizja...

Mars '94

BESI

Shkallët qënë prej druri dhe kërcisnin. Pastaj ajo hapi derën. Dhoma qe e vjetër. Më shumë se e vjetër, qe e pistë. Çarçafët, jastëkët, dyshemeja... gjithë ajri kishte erë lagështi. Muret qenë bosh dhe ajo qe shumë e bukur për të qenë lavire...

Jeta na kishte ndarë dhe unë kisha vite që s'r shihja. Një kohë isha rritur me të dhe e kisha dashur shumë. Po njerëzit harrohen.

Ajo u ul këmbëkryq mbi shtrat. Nuk më tha asnjë fjalë, njësoj si të më kish parë dje. Megjithatë, m'i nguli ato sytë e saj të zinj të butë, si dy sy fëmije... Ndenji një hop ashtu, pastaj u ngrit me përtim dhe më zgjati një cigare. Qe dobësuar shumë... Hoqi flokët nga sytë dhe e shoi cigaren pa e mbaruar. Pastaj shtriu këmbët në shtrat dhe ndezi një cigare tjetër. E mbajti midis gishtave, pastaj prapë e shoi... U mbështet fort pas karrikes. Nuk dija ç'të thosha. Në atë shpirt të boshatisur më bridhte vetëm keqardhja. Qe si ngërç. E thellë, e përnjëhershme, e shkurtër... Kisha një ndjenjë të keqe të brinjët... Doja të ikja prej aty. Të dilja dhe të

shtyhesha diku në rrugët me njerëz... Ajo më dukej aq e huaj, aq e ngrysur, aq e bukur, aq e dobët, aq e pandreqshme..., sa isha e pafuqishme t'a kundërshtoja... Unë nuk mund të bëja asgjë...

- Hajt ulu këtu... tha ajo... Zëri iu ndal dhe ktheu kokën në anën tjetër... - Kam marrë një mace... - tha pastaj. Ka emrin tënd...

Unë e përqafova dhe për një çast m'u duk tamam si atëherë kur qemë të vogla...

- Më mbaj fort... - tha ajo, - kshu...

- Ku shkuan ëndrrat e tua... - i thashë ngadalë...

- Humbën... ti nuk mund ta kuptosh... - tha pastaj... Fshiu lotët dhe drejtoi sytë nga unë... - Eshtë e vështirë të t'i tregoj të gjitha për një ditë...

Unë heshta. E dija që mund të flisja për orë të tëra, mund të qaja, mund të çmendesha, po asgjë s'do ndryshoja dot... Ishte ajo vetë që vendoste. Jeta ishte e saj. Unë do të dilja që aty e do merrja prapë rrugën time...

Ndeza një cigare dhe u ktheva nga ajo...

- Eshtë e kotë të them gjëra që ti i di, Besi... Ajo heshti. Në ballë iu duk një rrudhë. I shkonte. Unë gëlltita tymin dhe e ndjeva si rrëshqiti brenda meje. Qe i hidhur dhe i shkurtër...

Besi uli kokën. Sytë i kishte të prerë... - Eshtë vonë... -tha pastaj dhe zëri iu bë i mprehtë... Ndezi një

tjetër cigare dhe unë e dija s'e kësaj here s'do mundej më t'a shuante...

- Asnjëherë s'është vonë, gjersa vazhdojmë të marrim frymë... Asnjëherë Besi... Ajo tërhoqi fort tymin brenda saj dhe nuk foli. As unë nuk fola më... Rrija aty me mendjen time dhe me trupin tim të lodhur dhe nuk e dija pse duhet t'a kishte pikërisht ajo këtë fat... Ç'ka ndodhur thosha me vete... ku e ka fillin gjithë ky mallkim?...

Dhe muret shpërndanin më të keqin terr që kam parë... Ai vërtitej gjer tek unë nëpër çarçafët e zhubrosur, sikur donte të më merrte shpirtin... Ndërsa ajo ngjante e qetë dhe e mësuar me të gjithë këtë...

Kur ika më përcolli me ata sytë e saj të zinj e të butë. Pastaj thirri macen. E thërriste njësoj si mua... Macja iu ngjit nëpër trup dhe i ndali te supi. Ashtu me gjysëm zemre, ajo qeshi. Dhe qe shumë e bukur për të genë lavire.

Qershor '93

NJË HISTORI E HIDHUR

Në shpirt asnjë rresht dashurie nuk shkroi...
dhe kur vdiq, vetëm një lutje tha para se të ikte...
një kryq duke shtrënguar mes gishtërinjsh...
si peng, kur jeta po e linte.

'93

I KUSHTOHET D.Ç.

*...Përmbysen ditët dhe larg jemi sikur nuk jemi njohur
kurrë dhe unë nën çmendurinë time... vazhdoj si i
marrë të shkruaj mbi mur.*

Dritan Çomo

Ai vdiq nga leucemia. Dhe ishte vetëm 24 vjeç. Nuk kisha folur asnjëherë me të. Nuk e dija që shkruante. Pastaj më vonë kur lexova gjërat e tij.... nata një ndjenjë të çuditshme... M'u duk sikur kisha gjithë jetën që e njihja. Dhe mbaj mend që për të jam mbyllur e kam qarë, njësoj sikur ta kisha dashur. Do doja që një ditë t'i mblidhja në një libër gjithë gjërat e tij. Kështu të tjerët do mund të njihnin atë pjesë të shpirtit që ai e fshihte midis rreshtave dhe që unë mendoj se është shumë e bukur për t'u fshehur akoma. Dhe do doja të premtoja për këtë.

Ti nuk më dëgjon dot...
zëri im gjer te ty nuk arrin
unë mbi tokë, ti nën tokë
dhe as lotët s'më sjellin lehtësim.

Do doja e vdekur të isha me ty
kësaj dite e gjer kur të zgjasë...
se diçka të njëjtë e patëm në shpirt
diçka që përgjysëm na u nda...
Po zëri im gjer te ty nuk arrin
dhe këtë puthje trishtimi ti s'e ndjen
tani dhjetori është në mbarim
dhe kjo është gjithë ç'mund të them.

TY

E di që ke dashur të jem më e mirë
dhe kur kam heshtur më shumë të kam lënë pa gjumë...
sigurisht ndonjëherë e ke humbur durimin...,
ndoshta të kam lodhur shumë...
Por natën kur përkulesh mbi mua...
me fytyrën e bukur si engjell
ti s'e di që pas syve të mbyllur...
për ty fshihet një lot dhe një ëndërr.

PAMUNDËSI

E para gjë që vuri re kur hapi sytë, qe grija e atij mëngjesi. Ajo shtrihej tejprtej e pistë, e thellë, e pamatë... Majda rrëshqiti gjunjët poshtë batanijes dhe shtyu jastëkun... Qe një nga ato mëngjese, përballë të cilëve e ndjen veten më të pavendosur se kurrë... Nuk i bëhej të dilte prej shtratit... Mbi komodinë qe një gotë përgjysëm çaji. Zgjati dorën dhe hapi sirtarin. Ai mbrëmë i kish dhënë një spirancë të vogël prej druri. Mbështeti kokën në mur dhe e la spirancën mbi jastëk... Ndjeu një lloj zbrazëtie...

Nga pasqyra shikonin dy sy të hutuar, si të zënë në faj... Ajo la krëhërin dhe filloi të vishej... Pastaj pa orën dhe veshi këpucët. Në shtatë e kishte lënë te kryqëzimi. Ora qe shtatë e dhjetë dhe ai me siguri po e priste... Zbriti me nxit shkallët dhe vetëm kur doli në rrugë u kujtua që kishte harruar spirancën. Ajo kishte mbetur aty mbi jastëkun e saj, e bukur, e lëmuar, e panevojshme...

Ai u shkëput me mundim nga trupi i saj dhe heshti... Nata qe blu. Pafundësisht blu. Dhe nëpër tërë atë natë endej vetëm një yll... Ajo shikonte e trishtuar atë pikë të bardhë e të largët dhe i dukej sikur do të vdiste nga mërzia...

Për të dytën herë ai u shkëput me zor nga trupi i saj... dhe ndezi një cigare.

- Mbase ndodh ngaqë je e lodhur... - tha pastaj. Ajo nuk foli. Mori gotën me të dy duart dhe e afroi te buzët. Qe një verë e hidhur, e vjetër, e fortë... Majda nisi të qante. Lotët i shkëputeshin ngadalë... të mëdhenj e të rëndë... Ai shoi cigaren dhe iu afrua.

- Mos më prek, - ulëriti ajo dhe e shtyu me të gjithë forcën.

- Mos më prek po të them...

- Je çmendur më duket... - tha ai dhe për një çast iu duk sikur e gjithë ajo natë u shtyu me nxit brenda tij... Majda po vishej... Ai kapi duart dhe u mundua ta shikonte në sy...

- Pse? - tha pastaj. Dhe qe një pse tmerrësisht e trishtuar.

- Nuk e di... - tha ajo. - Nuk mundem... Dhe sytë i shkuan te ai yll i vetëm që dukej sikur po afrohej drejt saj... Ajo mori frymë thellë dhe për një çast iu duk sikur ai yll po e shikonte...

- E di që ti më do... tha ajo. E di... pastaj i preku lehtë dorën dhe e shtyu gotën drejt tij...

- Jo ti s'e di... tha ai... Dhe nga sytë i shkau një lot.

Majda heshti, iu duk sikur befas e shtrëngoi një gjë në stomak... pastaj u ngrit dhe shkoi afër tij... Dhe sytë i shkuan prapë tek ai ylli atje lart, që dukej sikur kurrë ndonjëherë s'do shuhej... Ajo qeshi për një çast pastaj u kthye dhe mbështeti bërrylat në gjunjët e tij...

- Ti dhe Deni ngjani pak te sytë... - tha ajo. - Nuk e di. Natën atij i zbuten sytë njësoj si ty... Pastaj në mëngjes i ngjajnë tmerrësisht të zinj e të mprehtë... Ai i përkëdheli duart pa mundur të fliste. Nuk donte të qante. Gjithmonë i kish urryer njerëzit që qanin... Majda po e shikonte. Ai kish vërtet sytë e Denit... Po aq të zinj, të thellë e të munduar...

- E dua shumë... - tha ajo befas. - Ti nuk mund t'a kuptosh... Dhe mbase të dukem e çmendur, po unë nuk mund të rri në shtrat me asnjë tjetër përveç tij...

Dhe ndonjëherë e urrej veten për këtë. Po është diçka që nuk e kapërcej dot... Dhe kam dashur njëqind herë të iki, kam dashur njëqind herë t'a harroj..., njëqind herë kam dashur... po asnjëherë s'kam mundur. Nuk e di, - tha ajo dhe i plasën lotët.

Ajo ia mori kokën ngadalë midis duarve, flokët i ngjanin si të larë nga drita dhe ai mori frymë me zor.

- Ndonjëherë më duket sikur jam e dënuar t'a dua, gjithë jetën... Majda ktheu sytë nga ai dhe fshiu lotët...

- Do doja të isha në vendin e tij... - tha ai dhe i afroi gotën te buzët. Ajo piu një gllënkë dhe iu duk sikur ai lëng i hidhur e i fortë i rrëshqiti gjer në gishta.

- Deni s'do t'a kapërcejë kurrë këtë që ndodhi... - tha ajo dhe tërhoqi zvarrë këpucët gjer te pasqyra. - Më vjen inat që s'jam e bukur... - tha pastaj dhe u kthye nga ai.

- Nuk e di pse më deshi pikërisht mua... Majda hapi çantën dhe nxorri një kuti të vogël që kishte brenda një tigër prej kartoni.

- Shiko... - tha ajo dhe qeshi. - Deni thotë që kur bëhem nevrrike më bëhen sytë si tigër. Ajo vazhdoi të qeshte, pastaj e qeshura iu shua ngadalë dhe nuk i mbajti dot lotët.

- Nuk e di pse erdha këtu... - tha ajo dhe rrotulloi gotën e zbrazur. - Nuk e di... - tha për herë të fundit dhe

hapi derën me nxit pa e kthyer kokën. Dhe ai ndenji pa frymë, gjersa hapat e saj humbën poshtë në rrugë.

Majda mori frymë thellë. Qielli kishte filluar të zbardhej e megjithatë ai ylli i saj qe akoma aty..., i vetëm, i ndritshëm e i bardhë... Dhe ajo befas nisi të vraponte... Dhe i dukej sikur po vraponte drejt tij...

3 muaj më pas.

- Denin e shoh rrallë... - tha ajo, dhe ndezi një cigare. Ditët ndonjëherë ikin shpejt, po ndonjëherë s'mbyllen kurrë...

Dhe natën e kam të vështirë të fle. Shiu më lodh... më lodhin të gjitha... Majda pa nga ai... - Mbase kështu shlyej një pjesë të fajit tim... - tha pastaj dhe nga lotët sytë iu bënë si të verbër.

Ai e përqafoi.

- Ajo që njeriu ndjen fort një herë, mbetet pastaj gjithë jetën. Ti e di... Dhe herët a vonë Deni do kthehet e ti do jesh prapë ajo Majda e parë, që gëzohej dhe për një fije të vetme dielli; - tha ai. Pastaj heshti dhe u mundua të kapërcente lotët.

Majda hapi sirtarin dhe e mori spirancën midis
duarve... Iu kujtuan fjalët e tij... Iu kujtuan të gjitha...
Dhe ndjeu befas një dhembshuri të pazakontë. Qe
pothuajse mall. Një mall i lehtë, i butë, i pafaj... E puthi
spirancën dhe e theu në sirtar. Pastaj shtyu kanatet dhe
pa qiellin. Dhe nata qe blu. Pafundsisht blu... E nëpër
tërë atë natë endej vetëm një yll. Ylli i saj.

Shkurt '93

DHE TI...

Dhe ti mërzitësh, sepse çdo ditë e mbrapshtë...,
është si një ëndërr e keqe që ti sheh në gjumë... Dhe atë
s'mund t'a shlyesh, t'a ndrrosh e t'a jetosh nga fillimi...

Shkurt '93

XIXËLLONJA

Shkelja nëpër një errësi të vazhdeushme e të butë... Qaja për ty që nuk ishe askund e që megjithatë cuditërisht ishte brenda meje... Dhe ashtu e mbetur me natën..., nuk e di pse e kisha ndjenjën, që në një tjetër jetë, në një tjetër vjeshtë, në një tjetër trup..., ende pa të njohur ty, megjithatë të kisha dashur... Pastaj, ashtu e shtrirë në dheun me të cilin një ditë do të mbulohesh..., si e zgjuar befasi nga një përfaqësues, unë pashë një xixëllonjë... Dhe as frymë s'mora dot... Ishte fare afër meje... Më vinte të qaja... Ajo sekondë e ndrithsme shfaqej e zhdukej njësoj si ti...

Iu luta të mos ikte. Vrapova pas saj. Qava... Dhe pikërisht në atë çast kur unë e humba nga sytë, errësira më përplasi me ty... Aty u zgjova.

Mbi komodinë që një cigare e shuar, e djeshme, e trishtë... U ngrita të lahesha. Pastaj kur uji nisi të lagte me ngulm ëndrrën time... unë ndjeva si u rrit mërzia brenda meje...

Maj '93

E SHKRUAR TË SHITUNËN

Si mundem t'a harroj tani shikimin tënd?...
Ajo dashuri që si strehë...
gjithë rrugët ku shkelja më çonin atje...
Dhe si e lidhur me pranga unë jam tani...
pa ty, gjer në grykë me mërzinë që më bren...
Dhe është po ai qiell që zbret poshtë çative,
është po ajo ëndërr që dua të zgjoj,
është po ai trup që hedh në shtrat çdo natë...
dhe po ajo zemër që të deshi atëherë...
Jam po unë...
Me po ato rrathë malli poshtë syve...
Dhe kaq afër të kam e s'të kam më...
Kaloj nga ty, pa mundur të të prek...
ngul sytë te ty pa mundur të të shoh...
në heshtje të flas, pa mundur të nxjerr zë...
Dhe e helmuar jam përditë nga pak...
si e vdekur bie çdo natë kur fle,
dhe vetëm në gjumë të takoj,
kur ngrihem ti nuk je...
Dhe unë mbyllem këtu sa një grusht brenda meje
me lotët që më mbysin e s'më lënë të jetoj...
por zemrën s'mundem t'a burgos...
zemrën të lirë e lashë të t'dojë...

Shtator, '93

MOS IK NGA UNË

Do doja mos mërziteshe më për fajin tim... Për gjithë ato gjëra që them e bëj mbrapsh padashur... Sepse ajo që ndjej është më e pastra, më e kthjellta, më e thella e më e pafundmja frymë. Gjer këtë ditë asnjëri s'më ka dashur aq shumë sa ti... E kjo është ajo e fshehta ime e vjetër, që unë e kam ruajtur brenda meje, prej atij mëngjesi të parë, të lagur nga shiu e gjer tani që po shkruaj... mos ik nga unë... Sepse ^{gjëherë} s'kam patur aq shumë shpresë në zemër, sa atëhere kur ti më deshe... T'i kisha sytë aq afër, sa më dukej sikur rrija e tëra brenda teje... Dhe të mendosh që atëherë kujtonim se asgjë s'do na ndante... Unë plasja te ty gjithë mërzinë e gjithë frikën time..., sepse ti si asnjëri tjetër dije të heshtje, dije të flisje, dije të falje... Dhe unë gjithmonë të gënjeja kur të thosha "s'të dua" ... sepse në të vërtetë, mezi prisja që të vija e të strukesha tek ty. Ti e di. Dhe kur të dëgjoja, sa herë që të dëgjoja, unë e ndjeja një zë brenda meje që më thoshte, se kurrë s'do mund të isha në shpirt aq e mirë sa ty... Dhe vetëm tani që po të humbas, e kuptoj sa e bukur ka qenë ajo kohë kur ti më doje... Dhe shpresoj të mos jetë vonë..., sepse pa ty unë nuk mund të jetoj as dhe një ditë të vetme... Ti je

gjithshkaja ime... Tjetër unë s'di të dua, s'mundem të dua, s'dua të dua... Dhe ti e di që sa më shumë mundohem t'a kapërcej këtë ndjenjë, aq më shumë ajo zgjatet... Dhe kjo më mërzit, sepse unë nuk e di se ç'duhet të bëj për të të pasur... Ndonjëherë harrohem e tëra pas teje, ashtu siç harrohesha pas qiellit kur isha e vogël, dhe qaj njëlloj si atëherë, sepse edhe ty si qiellin, nuk të arrij dot... Mos ik nga unë!...

Shtator, '93

DHE KËSHTU NDODH GJITHMONË

Ti thua pambarim që nuk është as faj, as frikë, as keq... nëse je në dashuri me të. Te ty po zgjohet një natë e re... Ti nuk je më ajo picirukja e dikurshme dhe dashuria nuk është më një lodër... Ajo është si një rrymë e fortë uji, që të përplas sa andej këtej e ti nuk mund t'a pengosh rrjedhën e saj... Ajo është e pandalshme...

Por herët a vonë, ti qan dhe s'mund të bësh ndryshe..., sepse dashuria..., ajo llampushkë prej qelqi që ndriçonte errësirat e tua të dikurshme... të rrokulliset padashur nga duart dhe thyhet. *M*ërmohet e humbet, njësoj sikur të mos e kesh pasur kurrë... Dhe ti je e dënuar të ikësh bashkë me natën... E për: aq dritë e aq terr sa të hodhi në shpirt ti i thua asaj lamtumirë... Dhe pastaj ndalon hapat dhe shikon rrugën ku ai iku, pa e kthyer kokën nga ty... Dhe ti thua me mundim një tjetër lamtumirë... (Nëse thuhet lamtumirë mes të gjallëve). Pastaj merr rrugën e nisësh nga të të çojnë këmbët. Dhe kështu ndodh gjithmonë.

Qershor '93

AJO DHE BETHOVENI

... Kur e dëgjoja ndjeja si mbushej zbrazëtia brenda meje... Ai më pushtonte e më sundonte që në minutën e parë... Dhe unë e doja atë. Pakuptuar as vetë kisha një jetë të tërë që e doja... Dhe sa herë qaja, sa herë bija e pazhveshur të flija, të gjithë herët që nuk doja të ngrihesha..., ngulja sytë te koka e shtratit tim dhe e shikoja...

Ndërsa tani, në këtë orë që po rrëshqet prej meje e po thërrmohet në asgjë..., ndjej që edhe atë e kam humbur... Dhe ku t'a dish mbase nesër do doja akoma të jetoja nëpër ato qindra orë jete që do vijjnë. Po sonte nuk mundem... Tmerrësisht nuk mundem.

Ajo as nuk ra të flinte, as nuk u zgjua dot më. Kurrë. E megjithatë nga kanatet e shtyra të dritares së saj, dëgjohej akoma simfonia e tij e pestë... Dhe ai shikonte në heshtje me sytë pafundësisht të trishtuar e fajtorë...

Mars '93

ATËS

Mos më përze nga zemra. Nëse ka njeri që më kupton akoma në këtë botë... je vetëm ti. Dhe me qindra herë kur unë bie e zgjohem nga dëshpërimi, ti je aty... unë e di. Ti je gjithmonë aty... Mos më përze nga zemra. Sepse sa herë që kam dashur të fshihem, të mbrohem, të rritem, kam ardhur te ty... Dhe sa herë të tjerët më kanë shtyrë, më kanë harruar, më kanë urreyer, prapë kam ardhur te ty... Përherë kam ardhur te ty... Sepse ti je krijesa më e pastër e kësaj bote... Krijesa më e mirë. Dhe ti, vetëm ti, gjen tek unë atë që të tjerët kurrë, s'do e gjejnë... Sepse vetëm ti më njeh vërtet. Unë e di. Kam gjithë jetën që e di...

Dhe mos më përze nga zemra..., sepse ti je muri ku unë qaj, përplasem, mbështetem... Ti je përgjithnjë më e lutura, më e shtrenjta, më e shenjta gjë imja... Dhe nëse ndonjëherë ka ndodhur që të kam shtyrë, nëse ndonjëherë ka ndodhur që të kam lënduar..., nëse kjo mërzia ime e pambaruar t'a ka thyer zemrën..., dije që më shumë të kam dashur. Pa masë të kam dashur. Tmerrsisht të kam dashur... Sepse asgjë në këtë jetë s'mund të vë mbi ty... Me ty unë jam rritur... Me ty kam mësuar të eci, të flas, të kuptoj... dhe nëse asnjëherë

s'kam mundur të të lehtësoj, nëse asnjëherë s'kam
mundur të të them, nëse as tani nuk mundem... Më fal!
Me gjithë ditët e mia, me gjithë jetën time, me gjithë
shpirtin tim po të lutem...

Sepse çfardo që të bëj unë tani e gjer në ditën time
të fundit, nuk mjafton më... Ne të dyja e dimë që nuk
mjafton më... Po ti mos më përze nga zemra!

Dhjetor, '93

NË ËNDËRR

Jam i dënuar të të dua, the ti...
unë në ëndërr të putha e të qesha,
pastaj u zgjova me vrik...,
E dënuara isha unë që të desha.

Gusht, '93

24 ORË ME ELMËN

Nuk do të të fut më në shtrat..., kështu i pat thënë ajo. Pastaj e kish zënë gjumi me gojën shtrënguar prej zemërimit... Ai qeshi. Kur inatosej ajo i thoshte gjithmonë kështu. Qe kërcënimi i saj më i preferuar...

Ndezi një cigare dhe u ul në tokë. Me sytë mbyllur ajo ngjante ndryshe... Kur inatosej ai kujtonte se ajo s'do pushonte më nga të sharat.. Edhe kur qante, edhe kur qeshte, edhe kur heshte... Ai gjithmonë kujtonte se ajo s'do të Reshte kurrë... Dhe akoma s'e besonte që pikërisht ajo, qe gruaja e tij... Kjo vjeshtë i kish gjetur bashkë për të dytën herë... Qindra mëngjese, pasdite, netë... Dhe ja ai që i bindej si budallai e rrinte aty në tokë... Kur ajo të zgjohej do i hidhej në qafë dhe do t'i pëshpëriste me zërin e saj të ngjirur, pastaj do i bënte mëngjesin, do i paloste rrobat..., dhe do pajtoheshin aq shpejt, sa hap e mbyll sytë... Pastaj, po të qe e dielë, ajo do i lutej të dilnin... Do i lutej me atë fytyrën prej fëmije, që mos ia prishte... Dhe do i varej e tëra pas krahut, pa ia ndarë sytë, gjersa pastaj të hutohej pas rrugëve me diell, pas vitrinave e pas qiellit...

Dhe do ktheheshin vetëm kur asaj t'i lodhehsin

këmbët e të mos mundej dot më... Ashtu gjithë ankime, ajo do të futej të lahej dhe ai do të ulej më në fund të çlodhej... Dhe pa u ulur mirë, ajo prapë do e thërriste... Ej, kam harruar atë, kam harruar këtë... gjithmonë e njëjta histori... Dhe ai me fytyrën e njeriut që s'i mbarojnë kurrë hallet, do ulej pastaj të hante atë supën me bizele dhe karrota që ajo e pëlqente shumë... e kështu që dhe ai duhej patjetër t'a pëlqente...

Ajo qeshte. Kishte një të qeshur kumbuese që atij pa ditur pse i sillte një lloj gëzimi. Çdo gjë që ajo bënte i sillte një lloj gëzimi... Dhe kur ecte nëpër dhomë atij i pëlqente t'a ndiqte me sy, t'a përqueshte, t'a inatoste... Ajo qe lodra e tij më e dashur...

Dhe tani flinte aty e zbehtë, e urtë e djersitur... Ai shoi cigaren dhe pa përjashta. Elmës gjithnjë i pëlqente të shikonte përjashta... Ajo rrinte ashtu e menduar, pastaj thërriste me nxit, afronte fytyrën tek ai, sikur do i thoshte ndonjë sekret dhe e pyeste: më ke xhan?... Dhe ai gjithmonë qeshte... Nëse pat ëndërruar ndonjëherë të jetonte me dikë, kjo ëndërr kish gjithmonë vetëm fytyrën e saj... Ajo qe çupëlina më e ëmbël që ai pat njohur...

Ndezi një cigare tjetër. Dora e Elmës qe varur në tokë. Unaza i kishte rrëshqitur dhe te majat e gishtave lëkurën e kishte të prishur... Ai ia mori dorën ngadalë...

Po të zgjohej ajo do të mbështeste kokën tek

gjunjët dhe pa ia ndarë sytë do i thoshte:

- Hë, më ke xhan?...

- Hë, më ke xhan?... përqeshi ai me vete... Dhe se si i erdhi... Ajo i kish thënë po kështu edhe atë natë... Kishte qenë nata e tyre e parë... Dhe ajo kish ndenjur urtë... Urtë ashtu si s'dinte të rrinte kurrë...

Ai qeshi. E dinte që ajo prapë do e merrte inat dhe do ngrihej e do ikte si e shkatërruar, pa e çarë kokën as për rrobat, as për lulet, as për qiellin, as për të... Dhe gjersa të kthehej do gjente si dreqi një shkak për t'u zënë... E prapë do i ngatërronte një rrëmuje të tërë fjalësh..., prapë do qante gjer në mesnatë..., prapë do i thoshte: nuk të fus më në shtrat..., e prapë do pendohej... Ishte po ajo vetë që e përzinte e po ajo që e thërriste...

Dhe ashtu e mbledhur kruspull, ajo do e pyeste edhe një herë akoma, edhe njëmijë herë të tjera, edhe gjithë jetën mbase...: Hë, më ke xhan? Dhe atij pa ditur pse, do i ngjante aq e vockël, aq e mirë, aq e pafaj..., sa ajo s'do mundej kurrë t'i thoshte, jo...

Po gdhinte. Elma po qeshte në gjumë. E djeshmja që fshirë krejt prej fytyrës së saj.

Janar, '93

FUND VJESHTE

Gjethet bien gjithnjë e më shpejt
nëpër netët e lagështa...
dhe zogjtë duket sikur ikin pa kthim...
pastaj mëngjeseve zgjohem nga ëndrrat e
mbrapshta...
dhe frika përsëritet në zërin tim...

'93

ATËHERE KUR TË LASHË TY

Ti më dëgjove gjer në fund...

pastaj heshte...

dhe atë cigare m'u duk sikur e shove në shpirt...

e unë që atëhere s'gjeta ^{me}prehje...

Dhe çdo ditë që nis, më thellë më gërvisht.

NJË HISTORI E VËRTETË

Fëmijë të shqyer nga plumbat... gropa mbushur me të vdekur që kurrë s'do kishin një varr... Endrra të humbura dhe frymë përgjithnjë të shuara... Aq shumë të vdekur, saqë filloje të ndiheshe fajtor nëse kishe mbetur akoma gjallë...

Ajo i kish parë si qenë shuar të gjithë njerëzit e saj, njeri pas tjetrit, si nëpër një ëndërr të keqe, ku nuk ke zë as të thërrasësh... Dhe e kish urryer tmerrësisht ditën kur kish lindur... Dhe që atëhere jeta e saj qe kthyer në një torturë të përnatshme kujtimesh. 20 vjet përpara ajo kish bërë një operacion, që të mos bënte kurrë fëmijë... Dhe të mendosh që i donte tmerrësisht fëmijët... Ishte çifute. Një çifute e bukur dhe e zbehtë...

~~Dhe~~ kish qenë vetëm gjashtë vjeç, kur i patën mbyllur në atë kamp përqëndrimi... Dhe që andej kish dalë pastaj fill e vetme..., sepse ata kishin mbetur aty. Përgjithnjë...

Dhe thonë që koha i rregullon gjërat..., po ndonjëherë koha nuk bën dot asgjë... Sepse edhe pas 32

vjetësh, asaj i dilte gjumi duke ulëritur... Dhe ajo kurrë s'mundi t'a kapërcente. Kurrë s'u bë dot aq e fortë. Gjithë jeta e saj kishte qenë një jerm i mundimshëm. Dhe qe mbasë e tepërt, të shpresonte edhe më, që një ditë do mund të zgjohej...

Një natë para se të vdiste, ajo i kish thyer të gjitha. Dhe pastaj kish mbyllur dyert, kish mbyllur dritaret, kish mbyllur gojën dhe ashtu fill e vetme kish rënë të flinte.

- Duhet të marrësh një qetësues...i kish thënë mjeku të nesërmen... Dhe ajo mori aq sa i mjaftuan përgjithmonë.

Prill '94

I KUSHTOHET B.M

- Sa daja ke ti Albana?...
- Një dajë të vogël.
- E do shumë dajën ti?...
- E dua.
- Sa e do?...
- Kaaç...

Ajo hap duart e saj të vogla, sikur do të pushtojë qiellin. Ajo është mbesa ime 4 vjeç, unë jam daja i saj 30 vjeç. Unë e dua shumë atë... Sa thjesht dhe kollaj thuhet kjo shprehje: E dua shumë!... Por kur rri pranë saj dhe kaloj pëllëmbët e duarve mbi flokët dhe qafën e saj delikate, më vjen një ndjenjë sikur duhet t'i ruaj duart e mia, se mos e shtrëngoj shumë... E dua këtë çupë gjer në çmenduri...

Ajo fut fytyrën e saj në gropën e supit tim dhe seç më thotë me muzikën e shushurimës së saj... Unë e mbaj ashtu të shtrënguar pas vetes dhe pastaj zë e puth, duke i thënë pranë veshit ca emra përkëdhelës, pakuptim e pothuaj të pazëshëm... Pastaj ajo kërkon t'i tregoj një përrallë dhe unë i flas për Kësulkuqen...

- Kul do të vish plapë ti daja?...
- Nesër.
- Po kul është nesël?... Të shtunën?
- Jo të shtunën.
- Po kul?... Kul të fle gjumë dhe të ngihem plapë në mëngjes?...

1976, Betim Muço

Të kujtohet?...

Këto janë një pjesë e atyre rrjeshtave që ti ke shkruar dikur për mua... Dhe tani që i lexoj më vjen të qaj... Nuk e di...

Ndonjëherë më duket sikur jemi të gjithë prapë atje..., në shtëpinë e vjetër të Atës... Dhe dua me gjithë shpirt të besoj që asnjeri nga ne s'mungon... Por kjo më mërzit më shumë, seps e ndjej që e kemi humbur përgjithmonë atë kohë... Dhe mbase ishte një kohë aq e pastër, aq e shkurtër, aq e ëndërrt, saqë të gjithëve n'a duket sikur s'e kemi pasur kurrë... Dhe mbaj mend që atëhere mezi prisja të rritesha, sepse nuk e dija që sa më shumë të kuptosh aq më shumë vritesh...

Më kujtohet që kur vdiq nënëja..., ti e more në krahë dhe e vure në shtrat. Në atë shtrat që s'më bën zemrat t'a kujtoj... Dhe që hera e parë që të shikoja duke qarë... Rrija mbështetur te dera dhe qaja në heshtje, pa nxjerrë zë, njësoj si ti. Isha vetëm 9 vjeç. Dhe nuk di pse i kujtoj tani të gjitha këto... Ndjej vetëm errësirën që mbushet dhe zemrën që zbrazet parreshtur. Dhe kam frikë mos të mërzis, po të vazhdoj..., e megjithatë e di që kjo s'do të ishte as e para herë, as e fundit...

Të kujtohet?... Ti më thërrisje në dhomën tënde, ashtu si bën tani, kur ke ndonjë gjë për të më thënë. Por atëhere kjo ndodhte zakonisht kur bëja ndonjë faj, sepse mami kurrë s'harronte të më spiunonte tek ti... Dhe është e çuditshme, por edhe kur ti më bërtisje ndonjëherë..., unë gjithmonë merrja inat atë..., jo ty... Dhe mbase ndruhesha pak, po frikë nuk të kisha, t'a dish... Sepse ti më doje... Dhe nga njerëzit që më kanë dashur unë kurrë s'kam pasur frikë... Por tani shumë gjëra kanë ndryshuar që atëhere, dhe unë po bëhem gjithnjë më e vështirë. Ti e di. Por ajo që ndjej për ty,

ka mbetur po ajo e atëhershme... E mbase është bërë
pak më e heshtur, më e pikëlluar, më e thellë...

Prill, '94

LINDËS

Ti mbështete kokën e lodhur mbi xham
dhe thua se gjithçka po mbaron...
Ë deshëm shumë dhe befaz një mëngjes...,
na duhet të ndahemi ndoshta përgjithmonë...
... Dhe si harroj dot netët në dhomën tënde...,
ëndrrat që lamë pas dhe ëndrrat që pritëm
kur unë doja të kisha një kitarë...,
në dy pasmesnate ti mësoje fizikën...
Dhe aq shumë kemi qeshur dhe aq shumë kemi qarë...
gjith'muzgjet e stinëve në një pikë loti të tharë...
dhe unë nuk di ç'të t'them më tani...
kokën mbështes si ty, dhe rri.

1990

VAZOJA ME LULE KINEZE

Qe hera e parë që ziheshin. Ai i kish thyer vazon me lule kineze që ajo e donte aq shumë dhe kish ikur duke përplasur derën... Tërë atë natë ajo s'pat mbyllur dot sy. Pastaj në të gdhirë e pat zënë gjumi pakuptuar dhe kish parë një ëndërr të keqe... Aq shumë kish uluritur, sa i dhimbnin brinjët... I qe bërë sikur ai ecte nëpër një rrugë terr dhe kthente vazhdimisht kokën mbrapa... Pastaj qe rrëzuar në një si humbëtitirë, dhe gjatë gjithë asaj rënieje, ajo s'pat mundur të mbushej me frymë gjersa ai qe plasur me forcë në tokë dhe ajo qe zgjuar në shtratin e zbrazët...

I ra me shkelm derës së ballkonit dhe ndjeu vjeshtë. Ajri kishte krejt erën e gjetheve që vyshkeshin... Ajo u mundua të qeshte dhe mori frymë ngadalë... Pastaj u kthye dhe vuri duart në gojë që të mos ulërinte. Te këmbët e saj që një zog i ngordhur. Milingonat e kishin rrethuar nga të katër anët dhe dukeshin sikur po e shqyenin... S'po mundej as t'a përkëdhelte, as t'a flakte... Pastaj kur u përkul dhe preku atë trupin e tij të vogël, u drodh e gjitha... E pastroi dhe e futi në një kuti... Ajo ditë po i ngjante si shtrigë... U mendua, pastaj zbriti shkallët dhe e la te

bari anës rrugës... Pushoi së pari dhe u fut të lahej.

Ai s'po kthehej. Kishte një parandjenjë të keqe, të pashpjegueshme., një si boshllëk në kokë..., një mërzi që s'i shqitej... Ajo humnerë e panjohur dukej sikur kishte dalë prej gjumit të saj dhe po hapej midis tyre...

Iu kujtua zogu. Kushedi sa larg i është dukur qielli në fund..., tha me vete... Ndenji edhe një hop ashtu, pastaj përnjëherësh i erdhi të flinte... U ul në kanape dhe nuk arriti të mendonte më asgjë... E zuri gjumi.

Po atë ditë ai u rrëzua me motorr dhe vdiq në spital një orë më pas. Ajo ende flinte. Dhe në gjumë po i bëhej sikur po ujiste vazon. Atë vazon me lule kineze që ajo e donte aq shumë.

Maj, '93

NJË FLETË NGA DITARI IM

E hënë 11 tetor 1993

... Dhe të mendosh që i kemi harruar të gjitha e jemi kthyer në dy kalamaj, që bëjnë garë me njëri tjetrin, kush shan më shumë dhe kush shan më keq..., a thua se është e pamundur t'a bëjmë përsëri të jetojë, atë që ndjejmë... Dhe kjo po më shkurton jetën. Unë urrej kur më kërkon që të të dua me urdhër e megjithatë urrej kur s'të bindem. Ti e di. Por unë gjithë ditën të mendoj dhe gjithë ditën të fshihem..., sepse brenda meje e ndjej që të të duash ty tani..., është njësoj si të duash një të huaj... Ti nuk je më ai i pari. Dhe kjo më mërzit... E megjithatë, unë ngrihem me vrap nga shtrati kur dëgjoj zërin tënd..., dhe prapë natën kam frikë për ty..., dhe prapë t'i njoh hapat..., dhe prapë e ndjej kur ti më mendon... Dhe ngjan sikur asgjë s'ka ndryshuar... e megjithatë, të dy e dimë që asgjë nuk është më si më parë...

... Dhe urrej që tani e kam të vështirë të fal pikërisht ty, që gjithmonë ke ditur të më falësh...

Të dua shumë megjithatë.

Dhe ti e di.

**Tani po të them natën e mirë, edhe pse
sonte s'do mundem më të fle.**

SHIU

Ishte shi. E mbuluar me batanije në qoshe të krevatit, unë e dija që ti po më prisje... Dhe tani më ndanin vetëm dy hapë nga ty... Doja të zbrisja e të vrapoja drejt teje, po zemrën e kisha të thyer... Asaj nate e lashë gjumin të më lidhte pas shtratit... Dhe ti prite e prite, nëpër atë shi që të mërziste shpirtin... Unë në ëndërr u kujtova dhe qava për ty.

SYTË E DASHURISË

Pastaj, kur kthente kokën dhe takonte ato sytë e saj të thellë, ai e ndjente gjer në fund të shpirtit se sytë po e shikonin..., qenë sytë e dashurisë... Ata e prapsnin, e lusnin, e thërrisnin..., ashtu ngjyrë ndryshku..., prej loti e prej drite siç ishin...

Dhe ai e njihte stinën e tyre të verbër..., ai i kish parë të shuheshin..., i kish puthur kur heshtnin..., qe trembur kur fshiheshin dhe i kish dashur kur ktheheshin...

Aq shumë i kish dashur, sa nuk mund të mos besonte se ata sy të mbetur ashtu si yje në sytë e tij..., qenë sytë e dashurisë...

Shtator, '93

LLOTARIA

Ai u mbështet pas murit dhe fishkëlleu. Ndenji ashtu pa lëvizur, gjersa dalloi atë qafën e saj të brishtë që u var pas parmakut...

- Shsht.. - ia bëri ajo dhe qeshi.

Ai tundi kokën dhe u fut tek ajo rrugica ku takoheshin gjithmonë. Pastaj ajo erdhi gjithë përtim, me ato këmbët e shtrembra që i hidhte një aty, një këtu... Kishte veshur një fustan bojë rozë dhe dielli i binte te flokët e te sytë... Ai po e shikonte... Ashtu e ndriçuar ajo ngjante si yll...

- Shpejt këtu... - tha ai duke qeshur... Gjithmonë kur i thoshte kështu, ajo bënte sikur inatosej...

- Hë ç'do... - tha me përtim... dhe u ul. Gjeti një copë shkumës te këmbët e tij dhe filloi të zhgarraviste në trotuar...

- Jam akoma përgjumësh... - vazhdoi... Ai s'foli. Ajo e pa një herë, pastaj i *hapi sytë* dhe vazhdoi të zhgarraviste... Ai ia çoi flokët pas veshit dhe e përkëdheli...

- Shiko... - tha ajo... Ai qeshi. Kishte vizatuar një shtëpi të vogël, një si kopësht dhe një lisharse...

- S'do i kem dot kurrë... - tha pastaj... La

shkumësin dhe fshiu duart te xhinset e tij...

- Po sikur t'i kesh... - tha ai dhe i shtypi majën e hundës. Ajo shtrembëroi fytyrën...

- S'po tallem... - vazhdoi ai. Kam fituar llotarinë...

- Ç'a the?... - ajo u hodh përpjetë... Dhe aq shumë u habit sa s'arriti as të gëzohej.

Qershor '93

NJË GJETHE

Mbi bar lëkundej një kordele e hollë,
e butë si një ëndërr vjeshte...
'dhe s'e dinte që nën mëndafshin e trishtuar të saj...
qe zgjuar dhe trëmbur një gjethe e djeshme...

QENUSHI

Qe e shtunë. Ajo ngjiti shkallët me zor. Gjithë atë ditë kishte pasur dhimbje koke dhe mezi po rrinte në këmbë. Kur hapi derën ndjeu një erë të çuditshme... Ai qe ulur mu mbi shtratin e saj dhe bënte si urti i dynjasë... Edi i kishte varur në qafë një kuti shkrepse. Ajo vajti ia shkuli gjithë inat dhe e hapi.

“S’të shkruaj dot gjatë se s’kam kohë. Ashtu më ka dalë një punë dhe duhet të iki në Durrës. Kthehem të hënë. Xhekin t’a solla që të mos mërzitesh.

Të puth Edi”.

- Idiot... - iu kthye ajo qenit. - Edhe ty të kisha mangut... Flaku kutinë dhe shkoi në aneks. Ai e ndoqi pas dhe filloi të bënte si i çmendur. Hidhej sa andej këtej dhe i ngatërrohej nëpër këmbë me atë turirin e lezetshëm prej qenushi... Ajo bënte sikur e kishte zët..., e shtynte, i binte me shapkë..., po ai as që donte t’ia dinte për të gjitha këto...

Të nesërmen kur u zgjua, shtëpia ngjante si e hedhur përmbys. Rrobat e saj qenë të gjitha në tokë, pudra qe derdhur mbi qilim, rimeli kish përfunduar te

këpucët, çorapet notonin te kovat e ujit..., kurse ai shtynte një portokalle sa andej këtej, si top.

- Shiko ti pis muti, unë të vdes; more vesh apo jo?...- ajo ulëriti. Ai vazhdoi të vinte rrotul me portokallin nëpër këmbë... Ajo e kapi si e tërbuar dhe e nxorri jashtë.

- Aty të rrish...- tha pastaj dhe përplasi derën.

Ai i gjuajti derës gjersa u lodh, pastaj heshti. Ajo u mbulua me batanije dhe s'e çau më kokën për të.

Të nesërmen kur hapi derën, ai kuisi. Qe mbledhur grusht aty në qoshe të shkallëve dhe rrinte. Asaj iu këput shpirti. E mori në duar dhe e përkëdheli. Ai po heshte në një mënyrë të çuditshme... Dhe përnjëherësh asaj iu duk si i ndryshuar... Mbase ajo natë, ashtu e gjatë dhe e ftohtë siç kish qenë, e kish rritur pak, ku t'a dish...

Gusht, '93

DITARI I ENDIT

4 janar '93.

Kam lindur nëntë vjet përpara, në po këtë datë. Këtë ditë e gjeta poshtë jastëkut kur u zgjova.

“Mos shkruaj anjëherë gjëra që s'i mendon vërtet... “Kshu tha mami dhe kshu do bëj... Tani që po shkruaj, ajo është shtrirë në divan dhe po fle. Është ora gjashtë, pasdite. Babi nuk është kthyer akoma. Nesër më ka premtuar që do më çojë te nëna dhe unë shpresoj që ai do t'a mbajë fjalën. Ndryshe do e marr inat. Dua gjysmën e tortës me mollë që bëri mami për mua, t'ia çoj nënës. Më ka marrë malli shumë. Nuk di a t'a mbaj nesër në rrugë këtë kordelen. Është e kuqe dhe babi më tha që më shkon shumë. Po ai kshu më thotë, për çdo gjë. Dhe ndonjëherë do e kap fshehurazi mamit dhe do i them: dëgjo ba, mos thuaj asnjëherë gjëra që s'i mendon vërtet... Po prapë kam frikë. Sepse sa herë unë i them ndonjë gjë, ai qesh dhe më thotë: mos përsërit fjalët e mamit... Megjithatë do mendohem. Tani duhet të mbaroj ushtrimet e matematikës. S'dua që kur të shkoj te nëna t'i marr librat me vete. Dhe nesër do i lutem mamit që të më lërë të rri atje, gjersa të mbaroj pushimet. Nëna ka në ballkon një vazo të vjetër që quhet lule akulli e që nuk prishet asnjëherë. Ika tani. Nesër do shkruaj prapë.

5 janar '93

Mami ka qarë gjithë ditën: Nuk e di ç'ka ndodhur. Dje më zuri gjumi herët dhe kur u zgjova babi nuk ishte në shtëpi. As tani nuk është. Dhe ora është prapë gjashtë pasdite. Kam frikë t'a pyes mamin. Ka gjithë ditën që rri mbyllur në dhomë. Bukën time e kishte lënë në tavolinë, po mua nuk më hahej. Nuk e di ç'u bë babi. U mërzita. Do numëroj gjer në dhjetë... jo, gjer në njëzet... dhe nqs as mami s'do pushojë së qari e as babi s'do të vijë do iki vetë te nëna.

6 janar '93

Dje numërova gjer në njëqind, po as mami s'pushoi, as babi s'erdhi, e as unë s'shkova te nëna. Qe errësirë dhe kisha frikë. Dhe i mora inat që të dy... Pastaj mora inat veten time dhe fjeta.

Megjithatë sot mami më kërkoi falje dhe ndenji gjithë kohën me mua. Kur e pyeta herën e parë për babin, nuk m'u përgjigj. Pastaj të dytën herë më tha që nuk e dinte ku kish shkuar dhe nuk harroi të thoshte, atë që tani e kam mësuar përmedësh: "Endi, mamit po i dhemb koka"., që domethënë fjalë për fjalë: "Endi mbylle gojën". Unë thashë njëherë që t'a merrja inat, po pastaj ndërrova mendje. Bile për çudinë time pastrova dhe tryezën... tani që po shkruaj ora është si gjithmonë gjashtë pasdite. Mami po rri te divan përballë meje.

Është hera e parë që e shoh të pijë cigare. Sytë i janë prerë dhe është zverdhur. Kam frikë mos sëmuret, tani që as babi s'është këtu. Dhe po u sëmur unë s'iki dot as nesër te nëna. Mezi pres sa të fillojë ndonjë film, se u mërzita. Me siguri që nesër dhe unë do sëmurem si mami.

7 janar '93

Këtë ditë s'do t'a harroj kurrë. Kur u zgjova në mëngjes dëgjova që mami po fliste me zë të ulët dhe po qante. Në fillin kujtova se po fliste me vete, ngaqë dera e dhomës qe mbyllur. Pastaj dëgjova zërin e nënës dhe shtyva dërrën. Bërtisja papushim nga gëzimi dhe harrova fare që mami po qante... Nëna më rregulloi flokët, më rregulloi bizhamet dhe pastaj më mori në prehër, e nisi të qante. Qava dhe unë. Dhe unë nuk e di pse, po atyre të dyjave ~~na~~ erdhi për të qeshur. Pastaj mami nisi prapë të qante dhe kur nëna m'a tha më në fund të vërtetën, unë s'dija ç'të bëja. Dhe tani që po shkruaj është si gjithmonë ora gjashtë pasdite. Bie shi. Po më dhembin bajamet dhe sikur mos mjaftojnë të gjitha këto, pak më parë qe një film që as dua t'a kujtoj. Sot, për herë të parë kuptova se të gjithë burrat janë tradhtarë. Dhe as me Gentin që kam në bangë, s'do t'a ndaj më bukën. E kam

vendosur. Dhe s' do të lë asnjë çun të klasës të kopjojë detyrat nga unë! Sepse edhe ata tradhtarë kanë për t' u bërë një ditë. Unë e di... Dhe dua të shkruaj tani që e urrej babin..., po mami më ka thënë që të mos shkruaj asnjëherë gjëra që s' i mendoj vërtet. Dhe kshu që nuk di ç' të bëj. Kam që në mëngjes pa ngrënë dhe nuk e di pse s' po sëmurem...

8 janar '93.

Mami kish shkuar në punë, dhe kshu që kur u zgjova nuk e gjeta në shpi. Nëna po pinte kafe. Jashtë binte shi dhe nuk e di pse, më erdhi të thosha: shiu më lodh, pastaj m' u kujtua babi që më thoshte: mos përsërit fjalët e mamit dhe nisa të qaj. Më kishte marrë malli shumë shpejt për të... Këtë s' ia fal vetes, thashë me vete. Dhe prapë thashë si mami. Pastaj nëna më bëri bukën dhe unë pranova më në fund të ha, me kusht të m' i tregonte të gjitha fill e për pe... Dhe tani që po shkruaj dhe ora është si gjithnjë gjashtë pasdite unë e humba durimin, dhe nuk e çaj më kokën, që po them si mami.

9 janar '93

Vazhdon të jetë shi. Nesër nëna do kthehet në shpi, po mua s'do më marrë me vete. Dhe kshu kam vendosur mos t'i flas. Mami pothuajse s'llet fare. Megjithatë pak më parë më mori hopa dhe më rrotulloi gjersa fillova të qesh. Dhe pastaj më dha fjalën që do flinim të dyja. Dhe kshu që tani që po shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite nuk jam dhe aq e mërzitur.

10 janar '93

Nëna iku, po unë nuk e mbajta dot fjalën... Dhe gjersa zbriti shkallët i thashë njëqind herë të kam xhan e njëqind herë s'të kam... Po prapë e putha që e putha. Nëna më tha që të kujdesem për mamin... Dhe e di që po kshu i ka thënë dhe mami për mua. Dje mami më lexoi një vjershë të Esenin. Pastaj para se të flinim, vura një këngë që ata të dy e dëgjonin pothuajse gjithmonë. Dhe për çudinë time nuk kundërshtoi. Pastaj unë e putha dhe m'u kujtuan gjithë kohët kur qemë të tre bashkë... Netët e verës, pasditet..., të djelat... M'u kujtua që sa herë kishte ditëlindjen mami, unë me babin vidhnim trëndafila... Shkonim gjithmonë te një kopësht i madh në periferi dhe bënim kërدينë. Dhe sa herë që mami pyeste: ku i gjetët?..., babi m'a bënte me shenjë dhe unë vetëm qeshja. Dhe tani që unë po shkruaj dhe

ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., mami po dëgjon Verdin dhe po qep pantallonat e mia. Dhe kur mendoj që për dy ditë nis shkolla, më futet tmerri.

Më janë dobësuar nervat shumë. Nuk e di. Me zor flas, me zor dëgjoj, me zor të gjitha. Këto fjalë po ia thoshte tezes në telefon... Dhe unë po i shkruaj, sepse edhe unë kshu mendoj. Ç'faj kam unë që ne mendojmë të dyja njësoj.

12 janar '93

Dje s'kam shkruar, ngaqë bëra mësimet. Mami ndenji me mua gjer vonë natën. Binte shumë shi dhe unë fillova të qaja. Nuk e di pse qaja. Mami e la dritën hapur gjer në mëngjes. Pastaj që të më bënte për të qeshur filloi të më tregonte numrat që bënte babi, kur unë isha e vogël... Dhe duke treguar filloi të qeshte dhe vetë. Kur e pyeta pastaj: a e do më babin? ajo tha, nuk e di dhe heshti. Megjithatë po të donte mund të thoshte dhe jo. Kshu që ka dhe më keq. Dhe tani që po shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., mund të them se nga të gjithë fjalët që kam dhënë gjer tani, asnjërën s'kam mbajtur, sepse bukën e ndava që sot me Gentin dhe prapë gjysma e çunave të klasës i kopjuan detyrat tek unë.

13 janar '93

I thashë mamit të më blejë një kordele tjetër. Kordelen e kuqe s'dua t'a vë, vetëm nga inati i babit... Mami dje më mësoi të kërceja. Pastaj më bëri sallatë ruse dhe në darkë vonë pimë të dyja një gotë verë që kishte mbetur, pastaj luajtëm shah dhe unë e munda. Para se të flinim mami më tregoi jetën e Bethovenit dhe mua më hipi në 11 të natës t'a dëgjoja. Dhe për herë të parë e dëgjova me vëmendje... Dhe të mendosh që vdiq i vetëm dhe i ^{shurdher} ~~verber~~, thosha me vete, ashtu si kishte thënë mami. Dhe tani që po shkruaj e ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., mua më ka shkrepur keq të mësoj pianon. Dhe siç thotë mami, s'ka gjë në botë që të m'a ndrojë mendjen. Tani ika, se kam gjithë ato mësimet për të bërë.

15 janar '93

Dje nuk shkrova se mami erdhi vonë në shkollë dhe shkuam drejt te nëna. Dhe më në fund isha e gëzuar sepse dje për herë të parë pas kaq ditësh, pashë diellin. Nëna kishte gjithë ato gjëra të mira dhe hëngra aq shumë sa filloi të më dhimbte barku. Pastaj bëra detyrat dhe dola në ballkon... Pashë lulen time të akullt dhe u ula me fytyrë nga dielli e m'u duk sikur ishim prapë në det.

Që të tre... Dhe m' u kujtua kur u lamë një herë në tetë të darkës dhe uji ishte aq i mirë, saqë unë s' doja të dilja... Dhe atë natë e mbaj mend që më doli gjumi dhe i pashë duke u puthur... Pastaj mbylla sytë dhe vendosa të fle, po unë gjithnjë e kam të vështirë t' a mbaj fjalën... Babi thërriste vazhdimisht emrin e mamit dhe... nuk dija ç' të bëja. Ora qe tre e mëngjesit... Dhe dje kur i kujtova të gjitha këto më dukej e pamundur që babi im të donte një tjetër më shumë se mamin. Dhe nuk e di pse m' u kujtua, që një herë, mami qe sëmurë dhe nuk hante dot asgjë... Dhe babi nisi t' a ushqente. Mami bërtiti në fillim, ashtu si bën gjithmonë, pastaj u bind. Dhe babi u kthye nga unë dhe më shkeli syrin. Dhe që të tre qeshëm... Kur mbylla derën e ballkonit dhe hyra brënda e gjeta mamin duke qarë. Pastaj nëna i bëri një kafe dhe unë fillova të mësoj gjeografinë... Kur dolën nga nëna, ora qe shtatë e gjysëm. Një orë më pas unë fjeta. Dhe tani që ora është si gjithmonë gjashtë pasdite, unë jam zyrtarisht pothuajse e rritur, sepse mami më dha më në fund lejen që të lahem vetë. Qëparë më preu majat e flokëve, ngaqë më ishin djegur. Dhe harrova të them që më ka blerë një kordele të bardhë. Genti më tha që më shkon, po unë nuk e besova. Dhe meqë ra fjala te Genti, sot më flai një stilolaps me dy ngjyra, blu dhe të kuqe. Me atë po e shkruaj ditarin. Dhe tani më në fund e vetmja gjë e mirë për këtë javë: Kur pyeta sot mamin.

a e do më babin? Ajo tha mbase, dhe qeshi. Dhe nuk do t'a pyes më, se kam frikë mos ndërron mendje. Të paktën do rri ca ditë e qetë.

17 janar '93

Shkuam në varreza. Dhe tani jam aq bosh... Nuk më bëhet asgjë, nuk e di. Kshu i tha mami nënës dje në telefon... Dhe unë mendoj tamam si ajo. Dje pashë varrin e një goce të vogël që kishte vdekur kaq sa unë. Dhe fillova të qaja. Tërë natën kam fjetur me dritë ndezur. Një herë më doli gjumi dhe m'u kujtua ajo ditë kur mami u kthye vonë dhe babi që bërë nevrík e ecte gjithë kohën rrotull shtëpisë. Pastaj kur erdhi mami dhe u puthën te dera, unë i thashë; pse s'e rref, o ba?... Rrife që të mos t'a bëjë më... Dhe babi bënte sikur i shkulte flokët... Dhe mami qeshte. Dhe unë fjeta prapë, gjer në mëngjes... Dhe tani që po shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., më ka marrë malli aq shumë për babin..., saqë kam frikë mos sëmurem. Unë nuk dua të vdes si ajo goca e vogël që pashë dje. Dhe ishte aq e bukur saqë unë kurrë s'do t'a harroj fytyrën e saj. Dhe kjo gjë s'do më lërë anjëherë të jem e lumtur. Sepse mami më tha dje, që unë do mërzitem gjithnjë e më shumë për të... Tani po dëgjoj Bethovenin dhe po pres që mami të mbarojë punët dhe të ulet, që t'i them

për pianon. Qëparë ndenja një çikë me Xhudin. Xhudi është lepurushi im prej koti, që ka një kapele prej kashte e që unë e dua shumë. Mami e kish ruajtur atë për mua, që para se të lindja... Dhe unë me Xhudin u bëmë shokë që në fillim. Po tani unë nuk kam aq shumë kohë sa të merrem me të, sepse jam rritur. Xhudi sot po më shikonte gjithë kohën me inat, sikur ia kam unë fajin që është budalla e s'kupton. Pastaj unë bëra sikur u inatosa dhe i thashë me ulërimë, pikërisht ato fjalë që më tha mami sot: Xhudi, më ler rehat se s'kam nerva të merrem me ty... Dhe kur mami hapi derën dhe sytë i qenë bërë si topa nga habia, mua me vërtet m'u ngritën nervat, se e dija që kur të shkonte andej do qeshte. Megjithatë, për çudinë time, edhe pse punët s'po shkojnë më dhe aq mirë, prapë e mbaj veten. Nuk dua që të qaj në sy të të tjerëve. Mami ka një zakon të keq, që qan edhe në sy të të tjerëve. Dhe mua më ngrihen nervat jo ngaqë e shikojnë duke qarë, po ngaqë i del rimeli dhe bëhet e shëmtuar. Megjithatë unë asnjëherë s'ia them këtë. Më kujtohet që vjet mami qe e sëmure dhe në fund të verës u shëmtua shumë. Dhe sa herë që babi e shikonte..., asaj i ngriheshi nervat dhe sa s'qante... Pastaj, mendohej t'i thoshte me zë të ulët: mos më shiko se s'duroj dot. Dhe është e kotë të them si përfundonin këto përpjekje sepse mami sa herë që flet kur nuk është mirë, përfundon gjithnjë me ulërima. Megjithatë më vjen keq, që sot

kam pothuajse gjithë ditën që marr anën e babit, sepse mami është treguar shumë e duruar me mua këto ditë. Dhe mbi të gjitha sot më ka bërë majonez dhe peshk të skuqur. Dhe nëq shkon mirë edhe ajo puna e pianos, rrezik që në darkë të pijmë kafe të dyja. Ika tani.

18 janar '93

Që kur ka ikur babi, mami e lë telefonin hapur... Si të marrë, si të mos marrë njësoj mërzitem, po i thoshte sot nënës. Megjithatë do e kem të vështirë t'ia ndrojj mëndjen. Ajo është shumë kokëfortë. Edhe babi e thoshte gjithmonë këtë... Më kujtohet që një herë babi i tha të dilnin dhe ajo nguli këmbë që jo. Jo dhe jo, thoshte. Dhe unë e mora inat. "Merre me zot, i thosha babit... Dhe pastaj vura duart në bel dhe i thashë ashtu si më thoshte ndonjëherë nëna mua: posi moj zonjë, gjithmonë ty do t'a vëmë veshin". Dhe qesha vetë, e mbaj mend. Kurse babi e mori mamin hopa si bebe dhe nisi të zbriste shkallët. Mami bërtiste dhe i thoshte, s'kam veshur këpucët. Dhe unë si e mençur që jam ia hodha që nga ballkoni dhe për këtë mami s'më foli një ditë të tërë..., Megjithatë tani që shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., unë mendoj që duhet t'i mbush mendjen mamit për punën e telefonit. Kam një parandjenjë që babi do marrë. Dhe unë e di që nuk do

asnjeri në botë më shumë se ne të dyja. Dhe tani, ajo që më gëzoi aq shumë dje... Mami më tha që do të më gjente një mësues për piano. Dhe dje tërë natën në ëndërr më bëhej sikur i kisha kapur flokët me fjongo dhe kisha veshur një fustan të bardhë, dhe këpucët i kisha të bardha, dhe i bija pianos në një sallon të madh, si te ato tregimet ruse që më lexon ndonjëherë mami. Dhe më e forta që që në fund Genti më solli lule. Dhe meqë ra fjala te Genti, sot nuk e ndava bukën me të dhe as që i fola fare ditën, sepse dje gjithë kohën shikonte Stelën. Tani ika..., se duhet të mbaroj mësimet.

19 janar '93

Kushedi ç'bën babi tani. Unë e di që e ka marrë malli për mua. Unë e di që e do mamin, po prapë kam frikë. Mami ka filluar të pijë shumë cigare dhe qan për gjënë më të vogël. Dje për shembull qau pse iu derdh qumështi. S'kam parë njeri që të qajë gjysmën e ditës, vetëm për një shishe qumësht. Megjithatë ajo s'e ka hallin aty. E di unë, e di... Kam frikë vetëm se po të vonohet babi shumë, do ma marri mamin ndonjë tjetër. Dje në autobuz, kur po ktheheshim për në shtëpi, një burrë ia kishte ngulur sytë mamin dhe s'po ia shqiste... Unë u bëra si spec nga inati ngaqë nuk dija ç'të bëja, i rëndova me të dy këmbët te gishtat, dhe ai ulëriti aq

shumë, sa gjithë njerëzit kthyen kokën. Ai kishte zgurdulluar sytë dhe më shikonte si i tmerruar, kurse mami s'po kuptonte asgjë... Dhe tani që po shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite, mua më kujtohen kohët kur s'kisha nisur shkollën dhe mami gjithmonë para se të flija më tregonte përralla. Dhe mbaj mend që atë verë ne rrinin gjithnjë të tre gjer vonë. Mami shtynte kanatat dhe ne uleshim përtokë dhe shikonim yjet. Dhe unë gjithmonë nisja atë numërim që s'mbaronte kurrë. Dhe ata qeshin me mua... Atëherë dëgjonim një melodi me violinë të Çajkovskit dhe mami gjithmonë me jepte një kupë me qershia..., që unë t'i haja të gjitha vetë. Po mua nuk më haheshin, po mos t'i ndaja me ata. Dhe më duket sikur po qaj tani..., po s'duhet t'a bëj këtë, sepse mami është tamam përballë meje dhe qëparë kur ngrita kokën po më shikonte. Ika.

20 janar '93

Dje prita gjer vonë se mos merrte babi. Po kjo nuk ndodhi. Mami ra të flinte para meje. M'u duk shumë e lodhur. Dhe kur e putha duke fjetur, më erdhi të qaja. Babin kam filluar t'a marr inat dhe sa herë që mami qan, mërzitem aq shumë, sa më duket sikur do të vdes. Dhe tani që po shkruaj dhe ora është gjashtë pasdite si gjithmonë, ka nisur një shi, që të merr

frymën..., siç thotë mami. Dhe unë as që dua të mësoj.

21 janar '93

Babi as sot nuk mori ~~Γ~~ që ai nuk do të marrë kurrë. Po unë nuk e besoj këtë. Qëparë erdhi një grua dhe mami më tha që të shkoja në dhomë. Unë e dija që nuk ishte mirë të përgjoja. Por duhet patjetër të përgjogja. Megjithatë ato flisnin me zë aq të ulët, sa që u torturova dhe si përfundim, s'mora vesh asgjë. Pastaj kur i humba të gjithë shpresat, dëgjova atë grua që e ngriti pak zërin dhe i tha mamit: Do bësh gabim po ta falësh... Dhe siç thotë mami, sa s'shkallova. Pastaj nuk shkoj shumë që u mendova dhe nxorra nga plehrat atë lëkurën e bananes që më kishte blerë mami në mëngjes, hapa derën e jashtme dhe e vura në fillim të shkallëve. Po prisja që ajo të ngrihej dhe të ikte. Ishte tamam aq errësirë sa më duhej. Në kohën që u hap dera e kuzhinës u futa në dhomë dhe po më rrihte zemra nga frika. As pesë minuta më vonë, dëgjova ulërimën e asaj idiotës që u rrëzua dhe zërin e mamit. Dola gjasme si e habitur. Mundohesha të mos qeshja. Ajo mbante bythën me dorë dhe rënkonte. Pastaj mami e përcolli gjer në fund të shkallëve dhe u kthye me vrap. Unë rrotullohesha nëpër shpi si e marrë. Kisha vënë Bethovenin. Dhe nuk e di se si mami është kaq e mënçur... sepse sa hyri brenda

më tha: Endi herë tjetër mos përgjo dhe fute lëkurën e bananes aty ku e gjete. Unë ngela në fillim si budallaqe. Pastaj qeshëm të dyja...

E dua shumë mamin. I dua shumë që të dy. Po nuk e di si do t'ia bëjmë ne të tre.

22 janar '93

Akoma nuk më besohet që babai është këtu. Dhe kjo ndodhi dje. Mami kishte rënë të flinte dhe unë po shikoja një film. Kur ra dera, doja të zgjoja mamin, po pastaj ndrrova mendje. Dhe kur pyeta kush është... dhe ai më tha! Endi jam unë..., u hodha përjetë dhe nisa të bërtisja nga gëzimi. Shkova zgjova mamin pa hapur derën dhe pastaj u ngatërrova me çelsin, që mezi rrotullohej dhe kur më në fund iu hodha në qafë, qava. Kur ktheva kokën mami ishte në sallon, tre hapa larg nesh. Kujtova se do e përzipte, kisha frikë mos fillonte nga ulërimat, kisha frikë aq shumë, sa si thotë mami më dukej sikur do të vdisja. Por ajo nuk foli fare. U kthye në shtrat dhe mbylli derën e dhomës. Unë s'po ikja dot nga babi. Pastaj i zgjidha këpucët, e ndihmova të hiqte pallton dhe shkuaam të dy në kuzhinë. E dija që do vije, i thashë dhe e putha. Dhe ai u mundua të qeshte. Po unë e dija që ishte i mërziur... Dhe nuk u çudita kur e pashë që qau. Edhe pse kurrë s'doja t'a shikoja ashtu... Babi,

ti asnjëherë s'duhet të bësh gjëra që nuk i do vërtet..., i thashë. Dhe për të parën herë ai nuk më tha, mos përsërit fjalët e mamit... Dhe tani që po shkruaj e ora është gjashtë pasdite, mamin e ka zënë gjumi te divani përballë meje dhe babi e mbuloi dhe i puthi flokët. Dhe mua më kujtohen tani të gjithë netët kur unë flija me mamin dhe babi para se të shuante dritën n'a mbulonte dhe na puthte që të dyjave te flokët... Kam harruar të them që sot kur shkova në shkollë vura fjongon e kuqe që më bleu babi për ditëlindje, Dhe Genti tha që isha bërë shumë e bukur. Dhe unë e lashë të më puthte në faqe. Nesër filloj mësimet e pianos. Dhe të hënën nëna do të vijë tek ne. Dhe mami sikur të mos ngjante kaq e lodhur kur flinte, sa tani, unë do isha sot njeriu më i lumtur në botë. Sepse më më fund jemi të tre bashkë. Dhe nuk e di pse m'u kujtua tani, ajo goca e vogël te varrezat. Do doja që ajo të ishte gjallë e të ishim shoqe të ngushta që unë t'i tregoja sa e lumtur jam tani që **mami është zgjuar dhe po shikon nga ai.**

Po puthen e unë do numëroj gjer në dhjetë, jo gjer në njëzet..., dhe n.q.s. s'ikin ata nga dhoma, do iki unë...

23 janar '93.

Dje numërova gjer në njëqind, po as ata s'ikën

nga dhoma, as unë s'ika... Dhe tani që po shkruaj dhe ora është si gjithmonë gjashtë pasdite..., mendoj se këtej e tutje duhet të mendoj më shumë për veten dhe për gjërat e mia. Sepse Xhudi është zemëruar keq me mua. Dhe meqë ra fjala edhe Genti është zemëruar me mua... Po unë s'mund t'a lë të më puthi përditë... Dhe sot iu ktheva gjithë nerva dhe i thashë: Akoma nuk e kupton që s'të dua më? Dhe mirë që s'ishte babi aty. Gentit të shkretë iu bë fytyra si budalla, dhe unë s'e mbaja dot të qeshurën. Këto fjalë ia tha mami, babit sot në mëngjes..., ngaqë babi s'po e linte të ngrihej nga shtrati dhe mami po bëhej vonë për punë. Po unë nuk u mërzita, as babi nuk u mërzit..., sepse ne të dy e njohim mirë mamin.

Tani ika, se kam akoma gjithë ato mësimet për të bërë. Po e di që ne të tre s'do ndahemi asnjëherë. Kshu tha dhe mami dje.

ASGJË VEÇ ZEMRËS S'DUA TË BESOJ

Nëse kurrë s'e çaj kokën ç'thonë të tjerët për mua...

Ti e di si e mendoj...

kur të vdes veç një gur do mbaj mbi shpinën e ditëve të
mia...

ndaj përveç zemrës s'dua të besoj...

'93

MJEGULLA

Ajo qe rritur në shtëpi të fëmijës. Dhe nëpër ato netët e saj të atëhershme, ajo gjithmonë rendte diku nëpër ca krahë të panjohur dhe thërriste papushim: o ma, mami... Po e gjithë kjo qe vetëm një ëndërr... Në dritë të diellit, ajo kurrë s'kish patur një nënë të vetën...

Pastaj kohë më vonë... në një nga ato ditë ku thonë se rri fati, ajo kish njohur atë. Dhe ai qe bërë jeta e saj... Me të ajo i kish patur të gjitha... Vetëm një gjë ai s'pat mundur t'ia shlyente kurrë... gjersa vdiq...

Zbriti nga autobuzi dhe mori rrugën e varrezave. Koha qe me mjegull. Ajo mbylli sytë. Pa ditur pse, filloi të kishte frikë. Ai vend dukej aq i heshtur e aq i shkretë..., sa ajo nisi të qante... Nga gjithë ajo mjegull, varret ngjanin si të palexueshëm... Asaj s'po i bënte zemra të shkonte më tej... Qe hera e parë që vinte aty vetëm. E dinte që ai ish diku aty rrotull, po nuk mundej të vazhdonte. Ajo mjegull sikur ia lidhte këmbët me pranga... I la lulet në varrin që kishte më afër dhe e tërhoqi shpirtin zvarrë, gjersa doli në rrugë.

Dhe kurrë s'e mori vesh që varri ku kishin mbetur lulet e tij, që varri i asaj gruaje që e pat sjellë dikur në jetë.

Maj '93

ENDRRAT NË PASQYRË...

Nesër ai kishte ditëlindjen... Në sirtarin e saj kishte një javë që rrinte ajo këmisha e tij e re me kutija-kutija, gri, të bardha, të zeza... Mbi të shkruar me nxit: I love you sir... dhe në fund të sortarit, afër ditarit të saj qenë dy lule me një bojë rozë të vrarë... dhe dy pëllumba që mbanin me ngulm një fill që ngjante sikur po këputej e që mbyllej në fund me dy zemra të vogla, të kuqe...

Ajo ia nguli sytë pasqyrës dhe qeshi... Kishte veshur atë bluzën rozë që i pëlqente atij dhe për një çast iu duk vetja po aq e pastër e po aq budallaqe sa atëherë. Pastaj lidhi duart te gjunjët dhe i erdhi të qante... Do donte t'a gjente diku midis njerëzve e t'i dilte befas përpara..., do donte të bëhej e bukur e me vete të kish një tortë luleshtrydhesh..., do donte të vishte një fustan të shkurtër ngjyrë deti, do donte që flokët t'i kish më të gjatë..., do donte të ngriheshin tek ajo lodra e madhe rrotulluese që ajo nuk ia dinte emrin... po që për një çast do i bënte të qeshnin e të fluturonin ashtu të kapur fort njëri pas tjetrit..., me sytë drejt një qielli mrekullisht të pastër, të madh e të afërt.

Do donte pastaj të dëgjonte Çajkovskin..., dhe për të djegur atë fije të fundit trishtimi..., ajo do donte

të pinin përgjysëm një cigare të vetme, dhe të iknin për
në det..., e të mbeteshin atje deri sa të llodheshin nga
rëra, nga dielli e nga puthjet... Dhe pastaj t'i thonin
njëri tjetrit "natën e mirë", të dy në një kohë... Dhe të
qeshnin, e ashtu duke qeshur të flinin...

Dhe jo se ajo harroi, që asniëri nga të dy nuk
mundej dot më, kaq shumë... *por sudikërit nga*
pasqyra e shikonin akoma dy sy ëndërrues...

31 mars '94

TY ASNJËHERË...

Kur heshtëm e heshtëm për orë të tëra...
dhe lotët mundohem të gëlltis...
e urrej botën, i urrej të gjitha,
po ty asnjëherë, t'a dish...

Mars '94